

## ARTIKULLI #11

# UNIVERSITETI I IOWA NDAN PRAKTIKAT E ANALITIKËS ARSIMORE ME KOLEGË NGA UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS:

## Përmirësimi i Kapaciteteve Analitike dhe Qasja në të Dhënat e Tregut të Punës në Kosovë

[SEPTEMBER 24, 2023]

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/15Dcr3ugzb3SCEppOKO7MPNT2zUOVHmmX>



Figura 1: Sesion trajnimi i Analitikës Arsimore në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës

Këtë vjeshtë, si pjesë e Aktivitetit të USAID, Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë, stafi nga universitetet publike të Kosovës po shqyrtojnë një qasje të re në përqafimin e të dhënave përmes një serie të sesioneve trajnuese mbi Analitikën Arimore, të udhëhequr nga Dr. Cassie Barnhardt, Profesoreshë e Asociuar në Universitetin e Iowa (UI) dhe Drejtoreshë e certifikimit pasuniversitar në UI për Kërkim Institucional dhe Efektivitet. Sesionet e analitikës arsimore synojnë të arrijnë objektivën e parë të Aktivitetit – rritjen e kapaciteteve analitike të universiteteve dhe qasjen në të dhënat e tregut të punës në partneritet me sektorin privat dhe atë publik. Ky aktivitet është mbështetur nga USAID dhe i zbatuar nga Universiteti i Iowa në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).

Analitika arsimore përfshin mbledhjen, procesimin dhe shfrytëzimin sistematik të të dhënave, për të kuptuar kushtet, performancën, strategjinë dhe vendim-marrjen organizative në arsimin e lartë. Shfrytëzimi efektiv i të dhënave është thelbësor për universitetet në përshkrimin, shpjegimin, dhe parashikimin e një game të gjerë të rezultateve në praktikën e arsimit të lartë. Universitetet që kryejnë funksione të analitikës arsimore po angazhohen në kërkim institucional dhe punë që lidhet me efektivitetin. Kjo qasje fuqizon universitetet për të vlerësuar mësimnxënien e studentëve dhe prodhimin e të diplomuarëve me aftësi që lidhen me industri.

Është identifikuar stafi nga universitetet partnere, në përbërje të stafit akademik, administrativ, sigurisë së cilësisë, dhe personel nga shërbimet për karrierë, për të shërbyer në ekipet e lidhshme të analitikës arsimore. Ata/ato janë identifikuar për shkak të përgjegjësisë të tyre profesionale, të cilat u kërkojnë të shfrytëzojnë të dhëna në vendim-marrje, proceset e llogaridhënies, dhe planifikimit organizativ. Përgjatë jetëgjatësistë së Aktivitetit *Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë*, anëtarët e ekipeve të analitikës arsimore po kalojnë nëpër trajnime mbi kërkimin institucional dhe qasjeve për efektivitet, përveç që janë të përfshirë drejtpërdrejt në implementimin e iniciativave për të dhëna që mbështesin universitetet në transformimin e rutinave të tyre, që në aspektin afatgjatë, përmbyndësojnë të dhënat në proceset e tyre.

Në Shtator 2023 është mbajtur një sesion trajnimi i cili ka ofruar një kuptim konceptual dhe praktik të analitikës arsimore. Trajnimi vuri theksin në atë se si të përdorën të dhënat e brendshme dhe të jashtme për të informuar veprimet organizative, dhe ofroi aftësi themelore dhe lidhshme të domosdoshëm që universitetet të fitojnë kapacitete më të mëdha analitike. Ekipet gjithashtu u angazhuan në diskutime se si të krijohen praktika të qëndrueshme për të dhëna dhe si të vlerësohet suksesi i studentëve në një llojllojshmëri të dimensioneve. Këto diskutime adresuan se si të vlerësohet ndikimi arsimor dhe mënyrat se si kjo mund t'i përgjigjet nevojave të shumë palëve-studentëve, universiteteve, dhe sektorit privat.




Figura 2: Sesion trajnimi i Analitikës Arsimore në Fakultetin e Agrobiznesit, Universiteti i Pejës

Në Tetor 2023, ekipet e analitikës arsimore nga tri universitetet partnere vënë përpjekjet e tyre në praktikë duke zhvilluar një anketë longitudinale gjithëpërfshirëse, e cila merr në konsideratë mënyrën se si universitetet po i mbështesin studentët dhe kompanitë në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, mësimnxënie në terren dhe me përvojë, dhe kërkim. Anketa do të vlerësoj perspektivat e palëve, duke mbledhur informata nga studentët, stafi universitar dhe bizneset, me fokus specifik në sektorët e TIK dhe Bujqësi. Anketa gjithashtu do t'u mundësoj ekipeve të analitikës të përshkruajnë gjendjen aktuale të funksionimit, duke ofruar feedback për programet e studimit, menaxhmentin e universitetit, dhe industrinë, dhe për ndërmarrjen e veprimeve aty ku nevojat për ndryshime janë më akute.

Duke trajnuar personelin e universiteteve dhe duke plotësuar ato trajnime me aplikim të mëvonshëm të aftësive, ekipet do t'u japin universiteteve kapacitete më të mëdha të brendshme që të bëhen organizata që drejtohen nga të dhënat – organizata që mund të prioritojnë rezultate që kanë vlerë për akterët e tyre të ndryshëm, kryesisht studentë dhe kompani. Integrimi më i mirë i praktikave të të dhënave do të siguroj që vendimet të bazohen në dëshmi dhe modele të obzervueshme. Dëshmitë mbështesin investimin në ndjekjen e reformave dhe përmirësimeve në arsim të cilat janë specifike, me kohë, dhe konsistente me objektivat e deklaruar dhe nevojat e akterëve. Për më shumë, studentët dhe kompanitë do të përfitojnë shumë nga universitetet duke vendosur të dhënat në qendër të punës së tyre; kjo do të mbështeste qasje më strategjike të dizajnit të punës praktike të studentëve në sektorin privat, organizimin e kërkimit universitar në mënyra qëllimore që lidhen me industrinë, dhe ndryshimin e kurrikulave që kultivojnë të diplomuar shumë të aftë.

*"Analitika e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e proceseve të vendim-marrjes për vlerësim të nevojave organizative dhe parashikimin e rritjes. Universitetet përballen me kërkesa gjithmonë në rritje për llogaridhënie, të cilat kërkojnë ndarje dhe analizë substanciale të të dhënave. Fokusi ynë në kërkim institucional dhe analitikë arsimore në Universitetin e Iowa ofron ekspertizë substanciale në metodologji për kërkim arsimor dhe*

*vlërësim. Ne jemi të përkushtuar të ndajmë këto praktika me kolegët tanë në Kosovë, me synimin e përmirësimit të shfrytëzimit të të dhënave nga institucionet arsimore për të transformuar praktikën arsimore përgjatë globit. Ajo që ne specifikisht synojmë të forcojmë me universitetet partnere në Kosovë është ndërmarrësia akademike në mënyra që shfrytëzojnë të dhëna për të forcuar partneritetet me sektorin privat të Kosovës..” – Cassie L. Barnhardt, Profesoreshë e Asociuar e Arsimit të Lartë dhe Marrëdhënieve Studentore dhe Drejtoreshë e certifikimit pasuniversitar të UI në Kërkim Institucional dhe Efektivitet*



*Figura 3: Sesion trajnimi i Analitikës Arsimore në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Universiteti i Prizrenit*